

URDHËR
Nr. 1011, datë 6.2.2017

PËR MIRATIMIN E MODELIT TË CERTIFIKATËS DHE DOKUMENTIT
IDENTIFIKUES ZYRTAR TË UDHËRRËFYESIT TURISTIK

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 dhe të nenit 119 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 57 dhe 58 të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”

URDHËROJ:

1. Certifikata e udhërrëfyesit turistik dhe dokumenti identifikues zyrtar i udhërrëfyesit turistik do të lëshohen nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes sipas formës dhe modelit bashkëlidhur si aneksi 1 dhe 2.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES
Milva Ekonomi

ANEKSI 1

MODELI I CERTIFIKATËS SË UDHËRRËFYESIT TURISTIK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Ministria e Zhvillimit Ekonomik,
Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes**



CERTIFIKATË

UDHËRRËFYESI TURISTIK

Kjo certifikatë i lëshohet

Z/Znj. [Emri, mbiemri i udhërrëfyesit turistik]

Lindur më __.__.__, në __.__.__

Banues në adresën [*adresa*]

për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik [*kombëtar/lokal për zonën [emri i zonës]/i specialitetit të veçantë për specialitetin [emri i specialitetit]*] në gjuhën/gjuhët [*gjuha*].

Lëshuar më __.__.__

E vlefshme deri më __.__.__

MINISTRI

ANEKSI 2

MODELI I DOKUMENTIT IDENTIFIKUES ZYRTAR

1. Forma dhe përmasat e dokumentit identifikues të udhërrëfyesit turistik

Dimensionet e dokumentit identifikues zyrtar të udhërrëfyesit turistik janë në përputhje me specifikimet e ISO 7810, me dimensione si vijon:

- Gjerësia: min. 85.47 mm max. 85.72 mm
- Lartësia: min. 53.93 mm max. 54.04 mm,
- Të katër qoshet të harkuara me rreze 2.88–3.48 mm.
- Trashësia e dokumentit identifikues do të jetë prej 0.76 mm.

Lloji i dokumentit: CR80 dhe CR79 ISO PVC bosh.

2. Përmbajtja e dokumentit identifikues të udhërrëfyesit turistik

Pamja e dy faqeve të dokumentit identifikues të udhërrëfyesit turistik është si në fig. 1 dhe fig. 2.

Fig.1: Pjesa para

	
DOKUMENT IDENTIFIKUES UDHËRRËFYESI TURISTIK	
Emri:	[emri, mbiemri]
Nr. i regjistrimit:	[numri]
Kategoria:	[kategoria, zona/specialiteti]
Gjuha:	[gjuha]
Vlefshmëria:	[data e fillimit- data e mbarimit]
	
UDHËRRËFYES TURISTIK I CERTIFIKUAR	

Fig. 2: Pjesa prapa

Ky dokument mund të përdoret vetëm nga mbajtësi i tij.

Në rast humbjeje ose moskthimi mbajtësit, lutemi dërgoni dokumentin pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.